Kronikë

Të shtëna me armë zjarri në Shkodër, 19 vjeçari plagoset aksidentalisht nga i mituri! Policia arreston të riun dhe nis hetimin për 15 vjeçarin

Nata e ndërrimit të viteve për pak sa nuk ka përfunduar në një tragjedi në Postribë të Shkodrës ku një 19 vjeçar u dërgua në spitalin Rajonal për të marrë mjekim pasi ishte plagosur në këmbë me armë zjarri.

Foto: Ilustruese

Redaksia
1 Janar, 14:59 | **Përditesimi: 1 Janar, 17:47**

Nata e ndërrimit të viteve për pak sa nuk ka përfunduar në një tragjedi në Postribë të Shkodrës ku një 19 vjeçar u dërgua në spitalin Rajonal për të marrë mjekim pasi ishte plagosur në këmbë me armë zjarri.

Mësohet se ngjarja ka ndodhur mënyrë aksidentale rreth orës 24:00, ku raportohet se fillimisht 19 vjeçari, i identifikuar si S.P ka qenë duke qëlluar me armë zjarri në ajër në një vend ku ka pasur edhe të mitur. Më pas i riu i ka dhënë pistoletën një 15 vjeçari për të qëlluar në ajër. Në mënyrën që 19 vjeçari ka dashur t'i marrë armën të mituriit, arma është shkrepur dhe për pasojë është plagosur në këmbë.

LEXO EDHE:
Zbardhet plagosja e të riut në Shkodër/ Policia: U qëllua aksidentalisht nga 15 vjeçari të cilit i dha armën! Në pranga 19 vjeçari, hetohet i mituri

Policia vuri në pranga 19 vjeçarin S.P për mbajtje pa leje të pistoletës e cila u sekuestrua nga oficerët. Ndërkohë është proceduar penalisht 15 vjeçari i cili ka pasur në dorë armën me të cilën u qëllua aksidentalisht 19 vjeçari.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 16:11

Zbardhet plagosja e të riut në Shkodër/ Policia: U qëllua aksidentalisht nga 15 vjeçari të cilit i dha armën! Në pranga 19 vjeçari, hetohet i mituri

Një 19 vjeçar është arrestuar nga policia e Shkodrës dhe një 15 vjeçar është proceduar penalisht për ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e djeshme në Postribë ku u raportua se një i ri është plagosur.

Mësohet se ka qenë 19 vjeçari ai i cili i ka dhënë pistoletën 15 vjeçarin për të qëlluar në ajër, dhe në momentin që ka tentuar t'ja marrë sërish arma është shkrepur duke e lënë të plagosur vetë 19 vjeçarin S.P i cili po merr mjekimin në spital ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Sipas hetimeve të policisë, arma me të cilën 19 vjeçari lëvizte dhe e përdori për të qëlluar në ajër, ishte pa leje.

B.V/Shqiptarja.com

TAG: Shkodër Postribë

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Mendoni se viti 2023 do të jetë më i mirë në aspektin ekonomik?

Po Jo nuk di

Lajme të tjera

Atmosferë elektrizuese në Shkodër! Pas spektaklit të fishekzjarrëve, shkodranët drejt lokaleve, festa vazhdon (VIDEO)
1 Janar, 00:38

'Shkërmoqet' Partia e Lirisë Shkodër! Deputeti Agron Çela dhe kryetari i degës Ndou bashkohen me PS! 'Asi nën mëngë' i socialistëve për bashkinë më 14 maj
30 Dhjetor 2022, 15:12

Shpërthim me tritol para banesës së një polici në Shkodër, dëmtohet makina e tij! Dyshohet se iu vu lëndë plasëse për shkak të detyrës (VIDEO)
30 Dhjetor 2022, 10:51

Tre persona u helmuan, Kujdesi Shëndetësor në Shkodër publikon analizat: Uji brenda normave të konsumit! Sekuestrohet shishja ku u servir
29 Dhjetor 2022, 14:02



Nënë e bir u helmuan, përfaqësuesja e hotelit në Shkodër: Ky ujë serviret prej vitesh këtu, kamerieri nuk e besoi, e provoi dhe u helmua gjithashtu
29 Dhjetor 2022, 13:50

Vërtetim i vazhdimësisë cinike dhe politike në ditën e buxhetit të Bashkisë së Shkodrës

Besi Bekteshi

29 Dhjetor 2022, 11:40

Tre të helmuar nga uji i ambalazhuar në një lokal në Shkodër, nëntë e bir drejt Tiranës! Report Tv siguron përgjigjet e analizave, shishja nga ku u konsumua e sekuestruar
29 Dhjetor 2022, 10:57

Babagjyshët në Luf të Pukës kanë emër dhe mbiemër! 2 shqiptarët në SHBA i paguajnë të gjitha borxhet e qytetarëve në dyqanin e fshatit
28 Dhjetor 2022, 18:36

Përplasja për Avokatin e Popullit, Balla për Report Tv: Të jetë pa lidhje politike, Ballanca nuk rizgjidhet! 14 maji? Do të fitojmë edhe në Bashkinë Shkodër

Ermal Qori

28 Dhjetor 2022, 16:06

Miratohet buxheti 3.2 mld lekë i bashkisë Shkodër, Spahia: Qeveria na ka lënë në harresë, marrim 7 herë më pak fonde për investime se bashkitë e tjera
28 Dhjetor 2022, 12:50

Mbahet shfaqja unike 'Betlehem' në fshatin e vogël të Hajmelit! Iniciativë e famullisë 'Shën Pali' e 'Shën Pjetri'
27 Dhjetor 2022, 19:18

Çelet për herë të parë në muzeun Shkodrës ekspozita me veshje antike liturgjike, organizatorët: Qëllimi është ngjallëzimi përmes kulturës

Ergys Kavaja

27 Dhjetor 2022, 16:28

HOROSKOPI
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje